

Përsëritje znj. S.,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim, përcjellë në adresën e kontaktit të Departamentit të Administratës Publike (DAP), me e-mailin e datës 02.04.2025, nëpërmjet së cilës kërkon informacion dhe të dhëna të ndryshme lidhur me rregullat e etikës në administratën publike, ju bëjmë me dije se:

Lidhur me pyetjet nr. 1 dhe nr. 2, nëpërmjet të cilës kërkon të informoheni mbi mënyrat e shpërndarjes së Kodit, fillimisht sqarojmë se, nuk ka një Kod Etike unik për të gjithë institucionet e administratës publike. Legjislacioni në fuqi dhe aktet e tjera, që rregullojnë aspektet e etikës dhe përcaktojnë zbatimin e detyrueshëm të rregullave të etikës në administratën publike, janë si vijon:

- Ligji nr. 9131 datë 8.9.2003 “Për etikën në administratën publike”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 874 datë 29.9.2021, “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;
- Manual praktik i DAP-it nr. 70 datë 21.01.2025 “Për etikën në administratën publike”;
- Udhëzim i DAP-it nr. 2 datë 21.01.2025 “Për rolin e njësive të burimeve njerëzore për zbatimin e legjislacionit për etikën në institucionet e administratës publike dhe për përcaktimin e procedurave të mbikëqyrjes nga Departamenti i Administratës Publike”.

Megjithatë, institucione të caktuara të administratës publike, mund të kenë miratuar kode dhe/ose rregullore të brendshme specifike për zbatimin e rregullave të etikës.

Sa i takon mënyrës së shpërndarjes së tyre, ju bëjmë me dije se, ligji nr. 9131 datë 8.9.2003, si dhe VKM-ja nr. 874 datë 29.9.2021, janë akte të publikuara në Fletoren Zyrtare, në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë nëpunësit publikë.

Në lidhje me mënyrat e shpërndarjes së Manualit praktik të DAP-it nr. 70 datë 21.01.2025, si dhe udhëzimit të DAP nr. 2 datë 21.01.2025, DAP i ka përcjellë zyrtarisht këto akte, nga momenti i miratimit, institucioneve që janë subjekt i zbatimit të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, si dhe i ka publikuar në faqen zyrtare të institucionit www.dap.gov.al.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, janë zhvilluar trajnime me sistemet ministrore, me qëllim njohjen dhe zbatimin e akteve të sipërcituara.

Për në tepër, referuar udhëzimit të DAP-it nr. 2 datë 21.01.2025, të lartpërmendur, njësitë e burimeve njerëzore të çdo institucioni, mbartin detyrimin për të krijuar një dosje me aktet ligjore dhe rregullatore mbi etikën dhe integritetin, si dhe për t’ua vënë në dispozicion çdo nëpunësi që ushtron detyrën pranë një institucioni të caktuar.

Në lidhje me pyetjen nr. 3, përsa i takon frekuencave dhe procedurave për rishikimin apo përditësimin e Kodit, në bazë të nenit 13, të VKM-së nr. 874 datë 29.9.2021, DAP ka përgjegjësinë

që në mënyrë periodike, të paktën një herë në tre vjet, të bëjë përditësimin e Manualit të Etikës, si në funksion të ndryshimeve ligjore, ashtu edhe për pasurimin e tij me praktikatat më të mira.

Përsa i takon pyetjeve që keni parashtruar në rubrikën “Mbështetja institucionale dhe këshillimi etik”, ju informojmë se, në nenin 18, të ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ndër të tjera përcaktohet se:

“Dispozitë zbatuese

1. Njësia e personelit është e detyruar t’i bëjë të ditur nëpunësit në çastin e punësimit të tij detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe që duhen respektuar nga nëpunësi.

2. Nëpunësi ka për detyrë të sillet në përputhje me këtë ligj dhe, për këtë arsye, informohet për dispozitat e tij dhe për çdo ndryshim ose shtesë.

3. Nëpunësi duhet të kërkojë këshillim nga njësia e personelit të institucionit kur është i pasigurt për të vepruar. Njësia e personelit të institucionit, për raste të veçanta, këshillohet edhe me Departamentin e Administratës Publike...”

Për më tepër, në pikën 1, të nenit 12, të VKM-së nr. 874 datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”, parashikohet se:

“ 1. Njësia e burimeve njerëzore është përgjegjëse për këshillimin e çdo nëpunësi të administratës publike për detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për standardet e sjelljes etike.”

Rregulla më të detajuara për zbatimin e këtyre detyrimeve janë përcaktuar më tej në këtë VKM, si edhe në dokumentat e reja të miratuara për rregullat e etikës, si “Manuali praktik i rregullave të etikës për nëpunësit e administratës publike” dhe sidomos në udhëzimin e ri “Për rolin e njësive të burimeve njerëzore në zbatimin e legjislacionit për etikën dhe përcaktimin e procedurave të mbikëqyrjes nga Departamenti i Administratës Publike.”

Pra, njësitë e burimeve njerëzore në çdo institucion duhet të kenë një njohje shumë të mirë të rregullave etike sipas legjislacionit në fuqi, për të realizuar këshillime dhe informime periodike për çështje të rregullave të etikës. Ndërsa, njësia e burimeve njerëzore për raste të veçanta, mund të këshillohet me DAP-in me qëllim zgjidhjen e rastit sipas ligjit.

Krahas këtyre parashikimeve ligjore dhe nënligjore, në kuadër të përmirësimit të zbatimit të rregullave të etikës në administratën publike, DAP ka komunikuar me institucionet e administratës publike, që janë pjesë e fushës së zbatimit të legjislacionit të sipërcituar, duke kërkuar caktimin e Këshilltarëve të Etikës në institucionet e tyre.

Këshilltarët e Etikës, do të jenë punonjës të njësive të burimeve njerëzore në institucion, që kujdesen konkretisht për zbatimin e detyrimeve të sipërcituara për këshillim dhe informim. DAP ka orientuar të gjitha institucionet e administratës publike që të marrin masat për caktimin e Këshilltarëve të Etikës, duke u kujdesur që ata të kenë aftësitë, burimet dhe mbështetjen e

nevojshme për të kryer rolet e tyre në mënyrë efektive. Aktet respektive për caktimin e Këshilltarëve të Etikës dhe të dhënat e kontaktit të tyre, duhet të përcillen zyrtarisht pranë DAP-it.

Sa i takon pyetjes nr. 5, për numrin e punonjësve të përfshirë në funksionin e këshillimit etik, duke qenë se, në çdo rast kjo kompetencë i përket njësive të burimeve njerëzore, ju informojmë se, nuk ka një numër specifik, pasi ky numër varion nga kapacitetet strukture dhe mundësitë e institucionit përkatës. Sa i takon numrit të Këshilltarëve të Etikës, ende nuk kemi të dhëna, pasi nuk ka përfunduar procesi i caktimit të këtyre pozicioneve në të gjitha institucionet e administratës publike. Gjithashtu, lidhur me numrin e kërkesave për këshillim etik, nuk kemi të dhëna të raportuara deri më tani.

Në lidhje me pyetjen nr. 6, se si vlerësohet ndikimi i rregullave të etikës, ju informojmë se, referuar kuadrit rregullator, evidentohen 2 nivele të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave të etikës, nga njësia e burimeve njerëzore dhe DAP.

Njësia e burimeve njerëzore është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve të sjelljes etike në institucionet e administratës publike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003, dhe VKM-së nr. 874 datë 29.9.2021, të ndryshuar.

Kjo strukturë ka të gjitha mundësitë që të marrë informacione në mënyrë të vazhdueshme për çështjet që kanë të bëjnë me rregullat e etikës në institucion.

Ndërkohë, DAP mbikëqyr:

- Vlerësimin e veprimtarisë administrative të njësisë së burimeve njerëzore, lidhur me njoftimin, konsultimin dhe trajnimin e nëpunësve/punonjësve të institucionit, mbi standardet e rregullave të etikës, sipas legjislacionit në fuqi.
- Kontrollin e shpërndarjes dhe plotësimit të autorizimeve, deklaratave dhe formularëve të administruar në dosjen e personelit.
- Verifikimin e zbatimit të rregullave të etikës, nëpërmjet grupeve të fokusuara, pyetësorëve të anonimizuar me nëpunësit/punonjësit e institucioneve, apo metodave të tjera të përshtatshme.
- Administrimin e pyetësorit për vlerësimin e burimeve njerëzore.

Në lidhje me pyetjen nr. 7, nëse ekziston një mekanizëm zyrtar për të ofruar këshillim konfidencial për zyrtarët e lartë dhe nëpunësit civilë, ju informojmë se, aktualisht nuk rezulton të ketë parashikime ligjore ose nënligjore të cilat përcaktojnë ekzistencën e këshillimit **konfidencial**, për të gjithë institucionet e administratës publike. Këshilltarët e Etikës të lartpërmendur, në çdo rast mund të ushtrojnë vetëm ato kompetenca dhe detyra që janë përcaktuar për njësitë e burimeve njerëzore, si pjesë e këtyre njësive.

Lidhur me pyetjet nr. 8, 9 dhe 10, mbi funksionimin e mekanizmit për këshillim konfidencial, ju bëjmë me dije se, për sa kohë që nuk është i parashikuar një mekanizëm i tillë, nuk disponojmë informacionin e kërkuar.

Në lidhje me pyetjet e rubrikës për këshillimin e brendshëm në institucione e veçanta, ju sqarojmë se, ashtu sikurse e kemi cituar edhe më lart, Manuali praktik i DAP-it nr. 70 datë 21.01.2025 “Për etikën në administratën publike”, nuk aplikohet për të zgjedhurit, për Kuvendin e Shqipërisë dhe as për anëtarët e Këshillit të Ministrave (Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat), për arsye se këto organe kanë miratuar akte të posaçme për parashikimin e rregullave të etikës.

Për më tepër, DAP nuk administron të dhëna lidhur me ekzistencën e këtyre mekanizmave të brendshëm për ofrimin e këshillimit konfidencial.

Lidhur me pyetjet në rubrikën për të dhënat mbi institucionin ju informojmë se, DAP është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave në 5 shtator të vitit 1994, dhe aktualisht në strukturë ka 61 pozicione.

Si përfundim, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 8, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Departamenti i Administratës Publike